



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 81-të të mbajtur më 03.02.2023 ka miratuar si në vijim.

Vendim

Procedura sipas lëndës me numër 12-7287/1 të datës 24.12.2021 është formuar sipas një denoncimi me pretendime për korrupsion dhe komprometim të procedurës së përzgjedhjes së studentëve të gjeneratës VII të Akademisë ----- të RMVS-së, **NDËRPRITET**

KSHPK-ja përcaktoi se në përputhje me dispozitat LPKKI-së nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme për arsye se për rastin konkret ka vepruar një organ tjetër, i cili ka ndërmarrë veprime nga kompetencat e sajë.

Lënda me numër 12 -7287/1 të datës 24.12.2021 të mbillet dhe të arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e Komisionit shtetërorë në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur është dorëzuar denoncim me nr. 12-7287/1, datë 24.12.2021, me pretendime për dyshime për korrupsion dhe komprometim të procedurës për përzgjedhjen e dëgjuesve të gjeneratës VIII të Akademisë ----- të RSMV-së dhe për abuzime të mundshme në softuerin për testimin e kandidatëve të regjistruar gjatë provimit kualifikues. Në rastin konkret, bëhet fjalë për dyshime për keqpërdorime gjatë zbatimit të procedurës për provimin e kualifikimit, pra se vetë procedura e përzgjedhjes së dëgjuesve është diskredituar përmes kallëzimit penal ndaj kompanisë që mbante softuerin me pyetje (-----), për shkak të të cilave, sipas parashtruesit, dyshime për korrupsion dhe komprometim të mundshëm, dhe për të cilën si provë kishte një njoftim zyrtar në faqen e internetit të Akademisë.

Në denoncimin e dorëzuar bëhet me dije edhe për tekstet e publikuara në media me titullin "-----" shkon në paraburgim, i ka drejtuar një tjetër të dyshuar për të fol profesionalisht që të mos e kuptojnë prokurorët..." ndërsa në mbishkrimet thuhej se gjatë veprimeve të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, gjatë bastisjeve, kompjuteri i -----

dhe u konfiskuan kompjuterët në "-----", ku ishte softueri për pyetjet e kandidatëve për Akademinë për -----, për te cilat pati dyshime ne opinion, kryesisht nga kandidatët për pranim në Akademi që kanë dështuar në testin që nuk ka mundur të fitojnë një përqindje kaq të lartë me 100 për qind të pikëve dhe dyshojnë se dikush po shet kodet me pyetjet e mbrojtura për provim.

Me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike në rastin e hapur, KSHPK-ja ka kërkuar nga Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të dhëna dhe informacione lidhur me veprimin e tyre kompetent pas kallëzimit penal të dorëzuar për rastin në fjalë. Pas kërkesës së Komisionit Shtetëror, Prokuroria Themelore Publike ka raportuar se ka ndërmarrë veprime për rastin në fjalë.

Nga sa u tha më lartë, KSHPK-ja konstatoi se për rastin konkret ka vepruar organi tjetër kompetent, i cili ka ndërmarrë veprime në kompetencë të tij dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHETËTORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska**

Dorëzuar deri:
- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: J.C.
Miratoi: Mr. V.G, Anëtar i KSHPK-së